LIGJ
Nr.10 283, datë 3.6.2010

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E NATO-S "PËR KOMUNIKIMIN E INFORMACIONIT TEKNIK PËR QËLLIME TË MBROJTJES"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen e NATO-s "Për komunikimin e informacionit teknik për qëllime të mbrojtjes", bërë në Bruksel më 19 tetor 1970.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6601, datë 17.6.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE E NATO-S
MBI KOMUNIKIMIN E INFORMACIONEVE TEKNIKE PËR QËLLIME TË MBROJTJES

Qeveritë e Belgjikës, Kanadasë, Danimarkës, Francës, Republikës Federale Gjermane, Greqisë, Italisë, Luksemburgut, Holandës, Norvegjisë, Portugalisë, Turqisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

palë në traktatin e Atlantikut të Veriut në nënshkruar në Uashington, më 4 prill 1949;

duke pasur parasysh se neni III i Traktatit të Atlantikut të Veriut parashikon që palët do të ruajnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre individuale dhe kolektive për t'i rezistuar sulmit të armatosur me anë të ndihmës së vet dhe ndihmesës së ndërsjellë;

duke pasur parasysh që një aftësi e tillë mund të zhvillohet ndër të tjera përmes komunikimit ndërmjet qeverive palë dhe organizmave të NATO-s mbi informacionin teknik të rezervuar për të ndihmuar në kërkimet e mbrojtjes, zhvillimin dhe prodhimin e pajisjeve dhe materialeve ushtarake;

duke pasur parasysh që të drejtat e zotëruesve të informacionit teknik të rezervuar të komunikuar në këtë mënyrë duhet të njihen e të mbrohen,

kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme:

Neni 1

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

a) termi "për qëllime të mbrojtjes" nënkupton fuqizimin e aftësive mbrojtëse individuale ose kolektive të palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut sipas programeve kombëtare, dypalëshe

apo shumëpalëshe, apo në vënien në jetë të projekteve kërkimore, projekteve të zhvillimit, prodhimit apo projekteve logjistike të NATO-s;

b) termi “Informacion teknik i rezervuar” nënkupton informacionin që në karakterin e tij është teknik, mjaftueshmërisht i saktë për përdorim dhe që ka vlerë në industri, si edhe që është i njohur vetëm për pronarin dhe personat në marrëdhënie me të, e rrjedhimisht nuk është i disponueshëm për publikun. Informacioni teknik i rezervuar mund të përfshijë për shembull, shpikje, skica, njohuri dhe të dhëna;

c) termi “Organizëm i NATO-s” nënkupton Këshillin e Atlantikut të Veriut dhe cilindo organ civil apo ushtarak në varësi të tij, duke përfshirë këtu Shtabin Ushtarak Ndërkombëtar, ndaj të cilit zbatohen ose dispozitat e Marrëveshjes mbi Statusin e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut, përfaqësuesve vendas dhe personelit ndërkombëtar, nënshkruar në Otava, më 20 shtator 1951, ose dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Shtabit Ndërkombëtar Ushtarak, të ngritur në pajtim me Traktatin e Atlantikut të Veriut, nënshkruar në Paris, më 28 gusht 1952;

d) termi “Qeveri ose organizëm i origjinës” nënkupton qeverinë Palë në këtë Marrëveshje ose Organizmin e NATO-s, që komunikon e para informacion teknik si të rezervuar;

e) termi “Marrës” nënkupton cilëndo qeveri Palë në këtë Marrëveshje apo Organizëm i NATO-s, që merr informacion teknik të komunikuar si të rezervuar qoftë drejtpërdrejt nga qeveria apo Organizmi i Origjinës, qoftë nëpërmjet një Marrësi tjetër;

f) termi “Zbulim në mirëbesim” nënkupton zbulimin e informacionit teknik ndaj një numri të kufizuar personash, të cilët marrin përsipër të mos e përhapin më tej informacionin, përveçse në kushtet e përcaktuara me hollësi nga qeveria apo Organizmi i Origjinës;

g) termi “zbulim i paautorizuar” i referohet çfarëdo komunikimi të informacionit teknik të rezervuar, i cili nuk është në përputhje me kushtet sipas të cilave ai iu komunikua Marrësit;

h) termi “përdorim i paautorizuar” i referohet çfarëdolloj përdorimi të informacionit teknik të rezervuar, të bërë pa autorizim paraprak apo jo në përputhje me kushtet, sipas të cilave ai iu komunikua Marrësit.

Neni 2

A. Kur për qëllime të mbrojtjes, informacioni teknik i komunikohet nga një qeveri apo Organizëm i Origjinës një apo më shumë marrësve si informacion teknik i rezervuar, secili marrës, në përputhje me dispozitat e paragrafit B të këtij neni, do të jetë përgjegjës për ruajtjen e këtij informacioni si informacion teknik i rezervuar, i cili është zbuluar në mirëbesim. Marrësi e trajton këtë informacion në përputhje me çfarëdo kushtesh që i janë vënë dhe ndërmerr hapat e përshtatshëm në përputhje me këto kushte për të parandaluar që ky informacion t’i komunikohet cilitdo, të publikohet apo të përdoret pa autorizim apo të trajtohet në çfarëdo mënyre që ka mundësi t’i shkaktojë dëm zotëruesit. Nëse një marrës do të dëshironte të bënte ndryshime në kushtet e vëna, marrësi, përveçse kur bihet dakord ndryshe, i drejton çfarëdo kërkese në lidhje me këtë qeverisë apo Organizmit të Origjinës nga është marrë informacioni teknik i rezervuar.

B. Nëse një marrës vëren se cilado pjesë e informacionit teknik, që i është komunikuar asaj si informacion teknik i rezervuar në kohën e komunikimit, ishte tashmë në posedimin e saj apo e disponueshme për të, apo ishte atëherë apo në cilëndo kohë i bëhet e njohur publikut, marrësi, për aq sa lejojnë kërkesat e sigurisë, njofton qeverinë apo Organizmin e Origjinës mbi këtë fakt sa më shpejt që të jetë e mundur dhe nëse është e nevojshme bën çfarëdo rregullimesh që duhen me to për vazhdimin e mirëbesimit, për ruajtjen e sigurisë së mbrojtjes dhe për kthimin e dokumenteve.

C. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk konsiderohet se kufizon çfarëdo mbrojtje të disponueshme për një marrës në çfarëdo mosmarrëveshje, që rrjedh nga çfarëdo komunikimi i informacionit teknik.

Neni 3

A. Nëse zotëruesi i informacionit teknik të rezervuar që është komunikuar për qëllime të mbrojtjes pëson dëm nga zbulimi i paautorizuar apo përdorimi i informacionit nga një marrës apo nga cilido ndaj të cilit marrësi ka zbuluar informacionin, ky marrës dëmshpërblen zotëruesin:

- kur ai është një qeveri, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të këtij marrësi;

- kur ai është një organizëm i NATO-s, përveçse kur bihet dakord ndryshe nga palët e interesuara, në përputhje me legjislacionin e vendit në të cilin gjendet Zyra Qendrore e këtij Organizmi.

Ky dëmshpërblim bëhet ose drejtpërdrejt ndaj zotëruesit ose ndaj qeverisë apo Organizmit të Origjinës nëse kjo/ky i fundit dëmshpërblen zotëruesin. Në këtë rast, shuma për t'u paguar nga marrësi nuk do të preket nga shuma e dëmshpërblimit e paguar nga qeveria apo Organizmi i Origjinës, përveçse kur bihet dakord ndryshe.

B. Marrësit dhe qeveria apo Organizmi i Origjinës, për aq sa lejojnë kërkesat e tyre të sigurisë, pajisin njëra–tjetrën me çfarëdo prove dhe informacion të disponueshëm dhe japin ndihmesën e duhur për të përcaktuar dëmin dhe dëmshpërblimin.

C. Me kërkesën e një qeverie Palë në këtë Marrëveshje ose të Organizmit të interesuar të NATO-s, mund të ngrihet një Komitet Këshillimor i përbërë vetëm nga përfaqësues të qeverive dhe Organizmave të NATO-s, të përfshira në transaksion për të hetuar dhe shqyrtuar provat dhe për t'i raportuar palëve të interesuara mbi origjinën, natyrën dhe qëllimin e cilitdo dëm. Ky Komitet mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut që të caktojë një anëtar të personelit ndërkombëtar që të jetë anëtar i Komitetit si vëzhgues ose si përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm.

D. Asgjë në këtë nen nuk cenon çfarëdo të drejte që zotëruesi i dëmtuar mund të ketë kundrejt cilësdo qeveri apo Organizmi të NATO-s.

Neni 4

Qeveritë Palë në këtë Marrëveshje zhvillojnë në kuadrin e Këshillit të Atlantikut të Veriut procedura për vënien në jetë të kësaj Marrëveshjeje. Veçanërisht këto procedura përmbajnë dispozita që rregullojnë:

a) komunikimin, marrjen dhe përdorimin e informacionit teknik të rezervuar;

b) pjesëmarrjen e Organizmave të NATO-s, komunikimin, marrjen dhe përdorimin e informacionit teknik të rezervuar;

c) krijimin dhe veprimin e Komitetit Këshillimor të parashikuar në nenin 3, C, më lart;

d) kërkesat për ndryshime të kushteve të vëna mbi informacionin teknik të rezervuar, siç parashikohet nga neni 2, A, më lart.

Neni 5

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet se prek angazhimet mbi sigurinë ndërmjet apo mes qeverive Palë në këtë Marrëveshje.

2. Secili marrës përcakton për të gjithë informacionin teknik të rezervuar që i është vënë atij në dispozicion sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje të paktën të njëjtën shkallë sigurie siç është përcaktuar për atë informacion teknik nga qeveria ose Organizmi i Origjinës.

Neni 6

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk ndalon qeveritë Palë nga vazhdimi i marrëveshjeve ekzistuese apo hyrja në marrëveshje të reja me njëra-tjetrën për të njëjtin qëllim.

2. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet sikur prek dispozitat e Marrëveshjes së NATO-s për Ruajtjen e Ndërsjellë të Sekretit të Shpikjeve në lidhje me Mbrojtjen, e për të cilat janë bërë aplikime për patenta, nënshkruar në Paris, më 21 shtator 1960.

Neni 7

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk zbatohet ndaj komunikimit ose përdorimit të informacionit teknik në lidhje me energjinë atomike.

Neni 8

A. Instrumentet e ratifikimit apo miratimit të kësaj Marrëveshjeje depozitohen sa më shpejt që të jetë e mundur pranë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat do të informojnë çdo qeveri nënshkruese, si edhe Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s mbi datën e depozitimit të çdo instrumenti.

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë pas depozitimit nga dy Palë nënshkruese të instrumenteve të tyre të ratifikimit apo miratimit. Ajo hyn në fuqi për secilën nga Palët e tjera nënshkruese 30 ditë pas depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit apo pranimit.

B. Këshilli i Atlantikut të Veriut do të caktojë një datë në të cilën Marrëveshja e tanishme do të fillojë ose do të pushojë të veprojë për Organizmat e NATO-s.

Neni 9

Cilado Palë mund të pushojë që qeni palë në këtë Marrëveshje një vit pasi njoftimi i saj i denoncimit t'i jetë dhënë Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat do t'i informojnë qeveritë e tjera nënshkruese, si edhe Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut mbi depozitimin e çdo njoftimi për denoncim. Sidoqoftë, denoncimi nuk cenon detyrimet tashmë të marra përsipër dhe të drejtat apo privilegjet e fituara më parë nga Palët sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit nënshkrues të autorizuar në mënyrën e duhur kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Bruksel në ditën e 19-të të tetorit 1970, në gjuhët angleze dhe frënge, duke qenë të dy tekstet njëlloj autentike, në një kopje të vetme që depozitohet në arkivat e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila do t'u përcjelli një kopje të vërtetuar qeverive të tjera nënshkruese dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.